



PUNIM DIPLOME

(Studimet në nivelin **MASTER**)

**Tema: “Analizë demografike e regjistrimit të popullsisë,
banesave dhe ekonomive familjare në Kosovë 2024”**

Mentorja:
Prof. Asoc. Dr. Mimoza DUSHI

Kandidatja:
Bleona SHEHU

Prishtinë, 2025

Abstrakt

Regjistrimi i popullsisë përbën një nga proceset më të rëndësishme statistikore të një vendi. Ai ofron të dhëna të plota dhe të besueshme për numrin e banorëve, shpërndarjen e tyre sipas territorit, strukturën demografike dhe karakteristikat sociale e ekonomike. Përmes këtij procesi krijohet një pasqyrë e qartë e gjendjes së popullsisë, e cila shërben si bazë për hartimin e politikave zhvillimore, sociale dhe ekonomike. Informacioni mbi popullsinë është i rëndësishëm për të kuptuar jo vetëm madhësinë e saj, por edhe dinamikën e ndryshimeve në kohë, si dhe ndikimet që sjellin migrimet, rënia ose rritja e natalitetit dhe faktorët e tjerë shoqërorë.

Procesi i regjistrimit realizohet përmes një operacioni të përqendruar, gjithëpërfshirës dhe sistematik për mbledhjen e të dhënave nga çdo individ rezident, çdo ekonomi familjare dhe çdo njësi banimi, brenda një periudhe të shkurtër kohore që zakonisht zhvillohet çdo dhjetë vjet. Në këtë kuadër, regjistrimi i vitit 2024 në Republikën e Kosovës paraqet një proces me rëndësi të shumëfishtë: nga njëra anë, si një veprim teknik dhe operacional për sigurimin e të dhënave statistikore të sakta; dhe nga ana tjetër, si një akt politik, institucional dhe zhvillimor që shërben për matjen e përparimit shoqëror dhe për rishikimin e planifikimeve strategjike të qeverisjes.

Historia e regjistrimeve të popullsisë në Kosovë dëshmon për rëndësinë që ky proces ka pasur në kohë të ndryshme, por edhe për vështirësitë që e kanë shoqëruar atë. Regjistrimi i parë u zhvillua në vitin 1921, ku Kosova kishte rreth 439 mijë banorë. Dhjetë vjet më vonë, më 1931, numri i popullsisë arriti mbi 552 mijë. Pas Luftës së Dytë Botërore, regjistrimi i vitit 1948 tregoi rritje të ndjeshme duke arritur mbi 733 mijë banorë. Tendenca e rritjes vazhdoi edhe në regjistrimet e mëvonshme: në vitin 1953 popullsia ishte mbi 815 mijë, në vitin 1961 mbi 963 mijë, në vitin 1971 mbi 1.24 milion dhe në vitin 1981 mbi 1.58 milion banorë. Këto të dhëna dëshmojnë një rritje të qëndrueshme të popullsisë së Kosovës gjatë shekullit XX, e ndikuar kryesisht nga shkalla e lartë e lindshmërisë.

Megjithatë, regjistrimi i vitit 1991 solli një problem të madh. Popullsia shqiptare e bojkotoi këtë proces për shkak të kushteve politike të vështira dhe mungesës së garancive për një regjistrim objektiv. Për këtë arsye, në vend të të dhënave të sakta u bënë vetëm vlerësime, të cilat nuk pasqyruan realitetin. Ky hendek i krijuar në serinë kohore të regjistrimeve të popullsisë ka penguar për një kohë të gjatë analizat e sakta demografike dhe krahasimet me vendet e tjera.

Gjatë periudhës së konfliktit të viteve 1998–1999, sigurimi i të dhënave statistikore u bë edhe më i vështirë. Nuk u mbajt regjistrim i rregullt dhe informacioni për popullsinë bazohej kryesisht në vlerësime të pavarura. Pas konfliktit, mungesa e statistikave demografike dhe sociale u bë një pengesë e madhe për zhvillimin e politikave të mirëfillta publike.

Regjistrimi i vitit 2011 përfaqëson një kthesë të rëndësishme për Kosovën. Ai ishte regjistrimi i parë pas shpalljes së pavarësisë dhe përfshiu një proces më të organizuar dhe më të standardizuar. Rezultatet treguan se Kosova kishte rreth 1.74 milion banorë, shifër kjo dukshëm më e ulët sesa vlerësimet e mëhershme. Kjo rënie e popullsisë lidhet kryesisht me emigracionin e madh të dekadave të fundit, por edhe me rënien graduale të natalitetit.

Nëse krahasojmë të dhënat e regjistrimeve, vërehet se popullsia e Kosovës nga viti 1981 deri më 2011 është rritur me vetëm rreth 155 mijë banorë, ndërsa nga viti 1991 deri më 2011 ka pësuar një rënie të dukshme prej mbi 200 mijë banorësh. Ky fakt tregon ndikimin e madh të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, si migrimi, tranzicioni politik dhe vështirësitë ekonomike.

Regjistrimi i vitit 2011, dëshmoi kalimin nga një strukturë me rritje natyrore pozitive drejtë një faze të stagnimit dhe transformimeve demografike afatgjata.

Regjistrimi i vitit 2024 është projektuar dhe realizuar si një proces më gjithëpërfshirës, digjital, me standarde të avancuara statistikore të bazuara në rekomandimet e Eurostat dhe UNFPA. Ai ka përfshirë përdorimin e pajisjeve elektronike për mbledhjen e të dhënave, trajnimin rigoroz të regjistruarëve dhe një fushatë të gjerë ndërgjegjësimit publik. Objektivi themelor ka qenë sigurimi i të dhënave të sakta dhe të besueshme për popullsinë rezidente, strukturën familjare, tipologjinë e banesave, si dhe dinamikën e lindjeve dhe vdekjeve në vend. Rezultatet preliminare të regjistrimit të vitit 2024 nxjerrin në pah disa trende të reja demografike. Si operacion, është i ndërtuar mbi normat e paracaktuara evropiane, shënon një hap metodologjik dhe institucional të rëndësishëm për konsolidimin e kapaciteteve shtetërore dhe transparencën demokratike. Rezultatet përfundimtare të regjistrimit të popullsisë në Kosovë për vitin 2024 nxjerrin tre rezultate kyçe: numrin e përgjithshëm të popullsisë 1,585,566 banorë, që shënon një rënie prej 154,259 individësh krahasuar me vitin; përshpejtimin e procesit të plakjes demografike, me rënie të grupmoshave të reja si dhe me rritjen e moshës mesatare në 34.5 vjet, poashtu me rritje të numrit së personave mbi 60 vjeç (254,167) dhe dominimin e popullsisë urbane (795,627) ndaj asaj rurale (789,939), duke reflektuar urbanizimin dhe migrimin e brendshëm. Sa i përket banesave, regjistrimi ka evidentuar

rritje të numrit të ndërtimeve të reja në zonat periferike të qyteteve dhe një rënie të qasjes në banim adekuat në disa rajone rurale të thella. Kjo pasqyron transformimet ekonomike dhe zhvillimin asimetrik rajonal. Të dhënat mbi ekonominë familjare kanë treguar një tendencë drejt zvogëlimit të madhësisë mesatare të familjes dhe rritjes së numrit të familjeve me një anëtar, si dhe një ndryshim të strukturës së brendshme të rolit gjinor dhe social brenda familjes.

Këto gjetje kanë implikime të drejtpërdrejta për politikën publike. Rënia e numrit të popullsisë dhe emigracioni i vazhdueshëm kërkojnë strategji të reja për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe për përmirësimin e kushteve sociale. Plakja e popullsisë nënkupton domosdoshmërinë e reformave në sistemin shëndetësor dhe pensional, ndërsa urbanizimi i shpejtë kërkon planifikim të kujdesshëm të infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Regjistrimi i popullsisë përbën një mjet thelbësor për transparencën demokratike, për planifikimin afatgjatë dhe për zhvillimin e qëndrueshëm. Regjistrimi i vitit 2024 ofron një bazë solide për politikën të bazuar në evidencë në fusha si arsimi, shëndetësia, infrastruktura dhe zhvillimi rajonal. Pa të dhëna të sakta demografike, çdo politikë zhvillimore mbetet jo mjaftueshëm e analizuar që mund të rezultojë joefektive. Përmes këtij regjistrimi, Kosova ka arritur të sigurojë një bazë të re të dhënash të standardizuar, e cila do të mundësojë planifikimin afatgjatë të zhvillimit ekonomik, social dhe territorial.

Fjalët kyçe: *Regjistrimi i popullsisë 2024, Kosovë, statistika zyrtare, analiza demografike*

Abstract

The population census represents one of the most important statistical processes of a country. It provides comprehensive and reliable data on the number of inhabitants, their territorial distribution, demographic structure, and social and economic characteristics. Through this process, a clear picture of the population's situation is created, serving as a fundamental basis for the formulation of developmental, social, and economic policies. Information on the population is crucial not only for understanding its size but also for analyzing the dynamics of changes over time, as well as the effects of migration, the rise or decline in birth rates, and other social factors.

The census process is carried out through a centralized, comprehensive, and systematic operation of data collection from every resident, household, and housing unit within a short time frame, typically conducted every ten years. In this context, the 2024 Census in the Republic of Kosovo represents a process of multiple importance: on one hand, as a technical and operational activity ensuring accurate statistical data; and on the other, as a political, institutional, and developmental act that serves to measure social progress and review the strategic frameworks of governance.

The history of population censuses in Kosovo demonstrates both the importance of this process over time and the challenges accompanying it. The first census was conducted in 1921, when Kosovo had approximately 439,000 inhabitants. Ten years later, in 1931, the number rose to over 552,000. Following World War II, the 1948 census showed a significant increase to more than 733,000 inhabitants. The upward trend continued in subsequent censuses: in 1953 the population exceeded 815,000; in 1961, 963,000; in 1971, 1.24 million; and in 1981, 1.58 million. These figures reflect steady population growth throughout the 20th century, primarily driven by high birth rates.

However, the 1991 census presented a major challenge. The Albanian population boycotted the process due to the difficult political circumstances and the lack of guarantees for an objective enumeration. Consequently, only estimates were made instead of accurate data, which did not reflect reality. This gap in the time series of population censuses hindered accurate demographic analyses and international comparisons for many years.

During the conflict period of 1998–1999, obtaining statistical data became even more difficult. No regular census was conducted, and population information relied mainly on independent estimates.

Following the conflict, the absence of demographic and social statistics became a significant obstacle to the formulation of effective public policies.

The 2011 Census represented a turning point for Kosovo. It was the first census conducted after the declaration of independence and involved a more organized and standardized process. The results indicated that Kosovo had around 1.74 million inhabitants — a figure considerably lower than previous estimates. This population decline is mainly attributed to large-scale emigration over recent decades, as well as the gradual decrease in birth rates.

Comparative analysis of census data shows that Kosovo's population increased by only about 155,000 people between 1981 and 2011, while between 1991 and 2011 it experienced a significant decline of over 200,000. This trend highlights the substantial impact of both internal and external factors such as migration, political transition, and economic hardship. The 2011 census thus marked the shift from a structure of positive natural growth toward a phase of demographic stagnation and long-term transformation.

The 2024 Census was designed and implemented as a more comprehensive and digitalized process, in accordance with advanced statistical standards based on Eurostat and UNFPA recommendations. It included the use of electronic data collection devices, rigorous enumerator training, and a wide-ranging public awareness campaign. The main objective was to ensure accurate and reliable data on the resident population, household composition, housing typology, and the dynamics of births and deaths. Preliminary results of the 2024 Census reveal several new demographic trends. Built upon pre-established European standards, this operation represents a significant methodological and institutional step toward strengthening state capacities and promoting democratic transparency.

The final results of the 2024 Kosovo Population Census reveal three key findings: a total population of 1,585,566 inhabitants, representing a decrease of 154,259 individuals compared to 2011; an accelerated process of demographic aging, with a decline in younger age groups and an increase in the proportion of persons over 60 years of age, particularly women; and for the first time, the urban population (795,627) surpassing the rural population (789,939), reflecting ongoing urbanization and internal migration. Regarding housing, the census identified an increase in new constructions in peri-urban areas and a decline in access to adequate housing in certain remote rural regions, indicating economic transformation and asymmetric regional development. Data on

households revealed a trend toward smaller family size, an increase in single-member households, and a gradual shift in gender and social roles within family structures.

These findings have direct implications for public policy. The decline in population and continued emigration necessitate new strategies for stimulating economic development and improving social conditions. Population aging calls for reforms in the healthcare and pension systems, while rapid urbanization demands careful planning of infrastructure and public services.

The population census remains an essential instrument for democratic transparency, long-term planning, and sustainable development. The 2024 Census provides a solid evidence-based foundation for policymaking in key sectors such as education, healthcare, infrastructure, and regional development. Without accurate demographic data, any developmental policy remains insufficiently informed and potentially ineffective. Through this census, Kosovo has established a new standardized data foundation that will enable long-term planning for economic, social, and territorial development.

Keywords: *2024 Population Census, Kosovo, Official Statistics, Demographic Analysis*